



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Zyra e Prokurimit
611-24-7014-1-3-6/C776



K O N T R A T Ë / F U R N I Z I M

Emri i Projektit **FURNIZIM ,MONTIMI DHE RREGULLIMI I POMPAVE DHE PJESEVE FAZONIKEPER NEVOJA TE KOMUNES**

Numri identifikues: **611-24-7014-1-3-6**, Datë: **16.08.2024** ; Nr. i arkivit: **02-400-01-4 0259**

PALET NË MARRËVESHJE

KOMUNA E DRENASIT - Drenas, përfaqësuar nga **GENTIANA QELA** Zyrtar i Prokurimit (me titje "Punëdhënëse").

Treing SH.P.K., Rruga Dëshmorët e Pionerit, 69, Prishtinëpërfaqësuar nga **ULJAN THAÇI**, Drejtor (me titje kontraktuese).

Neni 1 Ligji i aplikueshëm

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Ligji Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237. Për çështjet që nuk mbulojnë me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykatë përkatëse në Prishtinë. /

Neni 2 Lënda

Lënda e kontratës duhet të jetë : **FURNIZIM ,MONTIMI DHE RREGULLIMI I POMPAVE DHE PJESEVE FAZONIKEPER NEVOJA TE KOMUNES**

Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e kushteve të kontratës dhe të aneksit teknik, duke përfshirë të gjitha ndryshimet në varianin e propozuar.

2.1 Vendi i pranimit të furnizimeve do të jetë Komuna e Drenasit, Inkotermi i zbatueshëm do të jetë **DDP¹**. Periudha e kryerjes së punëve/shërbimeve dhe furnizimeve do të jetë deri në afatën : **10** dite.

Neni 3 Gmimi

Gmimi i furnizimeve është në shumën prej: : **1,850.00 €**, *Njëmijë e Tetëqinda e Pesëdhjetë* Euro.

3.1 Gmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka bërë Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të gnimave të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të gnimat sipas bërësve përkatës)

3.2 Pagesat do të bëhen në pajtim me kushtet e kontratës

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.
Pagesa do të kryhet çdo herë kur raportin menaxherit të projektit, duke mos e tejkaluar shumën prej: : **1,850.00 €**;

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të leshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data

e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3 Kryetari i komunës, Autorizohet në bazë të Nenit 81 të Ligjit Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 të caktot me një vendim, Menaxherin e Projektit zyrtarin me përvojë në profesion dhe mundësisht nga Krytari i Komunës.

4.4 Komisionin për pranim i caktojë Njësit kërkuese. Afati i kryerjes së furnizimeve duhet të jetë brenda 10 ditë. Pranimi duhet të kryhet konform neneve të kontratës dhe duhet të jetë konform Pjesës IV, Neni 81, pika 1, 2 dhe 3 të Ligjit mbi Prokurimin Publik Nr. 04/L-042 dhe dokumentacionit dyresor. Monitorimin e kesaj kontrate dhe pjesët e Planit të Menaxhimit e kryen Drejtozia per SHENDEFTSI

- a) Të gjitha pagesat kryhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat me të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivin. Përqindja % e pagesës, të furnizimeve të kryera do të caktohet nga menaxheri Poashtu zyrtari për pagesë para se të kryhet pagesa duhet të bindet se fatura është konform kërkesës dhe cmimorës që është pjesë e kontratës. Çdo fature duhet të pranohet nga Menaxheri i Projektit.
- b) Të gjitha dokumentet si: aktvendimet, procesverbale, raportet për furnizimeve të kryera, faturat, shkrësat, etj. duhet të dorëzohen tek Zyrtari për pagesë.
- c) Zyrtari për pagesë dhe arkivin të lendeve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimi, urdherit për pagesë dhe urdherblerjes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve/shërbimeve/punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit, dhe në pajtim me Menaxherin e caktuar nga Krytari i Komunës.

Neni 7 Garancioni i furnizimeve

7.1 Garancioni për eliminim të metave të furnizimeve do të jetë një vitë.

Neni 8 Vonesat në elzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] | të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [e kryej ndonjë ose të gjitha punet] brenda limitëve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa parasysh ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilin ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë demet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10% të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi dhe caktimi i menaxherit

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtrinë, dhe të kontrollojë përpunimin e përgatitjes, fabrikimin apo prodhimin të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të percaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtrina kanë cilësi dhe sasine e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontrate do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i parajguar arsytet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërpërçja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërprejë kontratën në ndonjërin nga raste në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dëshon në ekzekutimin e kontratës në afatit e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dëkujt kontratën apo nënkontraten pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Falimenton; f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikatit; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res-judicatit për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë pafatesi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës.

Neni 12 Ndërpërçja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërprejë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës mësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.


13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në në pajtim me ligjin e Kosovës, Jurisdiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap TITULLIN e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të derghet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Pjesë e ofertes është paramasa dhe parallogjaria e ofertesit. Kontrata hynë në fuqi me menjëherë pas nënshkrimit.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	GENTIANA QELJA	Emri:	ULJAN THAÇI
Pozita:	ZPP	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	19.08.2024	Data:	19.08.2024
Vula:		Vula:	

OFERTI

NR. OFERTËS

DATA

Per: Komuna e Drenasit
Objekti: Komuna e Drenasit
Rrugë:
Linda: Ofertë për furnizimin, montimin dhe testimin e STP dhe rrjetit të ujit.
Materiale: I nderuar klient,

Oferri duhet bazuar në projektin e objektit të Komunes dhe gjendjes ekzistuese të STP.
Referuar dizajnit dhe përshkrimit teknik nga projekti kryesor për objektin në fjalë, parashihen këto aktivitete:

PUNA E DORËS PËR DEMOLIME					
Nr.	Përshkrimi	Mësi	Sasia	Çmimi	Totali
1	Demontimi i pompës së dhe pjesëve tjera perçelëse	Komplet	1.00	150.00	150.0 €
2	Furnizimi veridojë dhe pompës së ujit me karakteristikat perçelëse per furnizim me uje te objektit te Komunes se Drenasit	Komplet	1.00	1,150.00	1,150.0 €
3	Fidhngjel per montim te pompës	Komplet	1.00	300.00	300.0 €
4	Testimi pas montimit te pompës	Komplet	1.00	250.00	250.0 €
TOTALI I PUNËS SË DORËS					1,850.00 €